REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
Pranuar më: / Primljeno: 28.03.2024
Mjësia / Jedinica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak
01-016/01-16789

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**ZYRA E KRYETARIT**

| | |
|---|---|
| **Datë:** | 27.03.2024 |
| **Referencë:** | |
| **Për:** | Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit<br>Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit |
| **Kopje:** | Diamant Bytyqi– Nënkryetar i Komunës<br>Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës |
| **Nga:** | Komisioni për hartimin e Panit në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsutlimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit. |
| **Lënda:** | Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 |

## Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për Draft–Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsutlimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konlsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky plan si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

Shih linqet: https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42297

https://www.facebook.com/photo.php?fbid=670263618461323&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3

**Ecuria e Procesit**

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës njoftimin për debat publik për Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026

në linkun: https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/03/ndp12698.pdf

https://www.facebook.com/photo.php?fbid=795138162640534&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 07.03.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga orëa 10:00-11:30

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

https://www.facebook.com/komunalipjan/posts/798746568946360

Nën kryesimin e Nënkryetarit të Komunës Diamant Bytyqi njëherit edhe kryesues i komisionit për hartimin e këtij Plani e hapi takimin me ç'rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falenderuar për pjesemarrje ka thën se ky plan veprimi është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga Kryetari i Komunës, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale.

Për realizimin e këtij plani lokal të veprimit, Kryetari i Komunës së Lipjanit ka marrë vendim për themelimin e Grupit punues me datë 12.01.2024 për hartimin e "Planit Lokal të Veprimit për *Barazi Gjinore* 2024-2026, në Komunën e Lipjanit", me këtë përbërje:

1.Diamant Bytyqi – Nënkryetar i komunës, Kryesues
2.Hasan Luma,NJDNJ-zyrtar për Barazi Gjinore, anëtarë
3. Valdete Muji,Zyra Ligjore anëtare
4.Xhevahire Zeqiri,Sektori për Përsonel, anëtare
5.Linda Shahini,Zyra për Integrime Evropiane, anëtare
6.Jalldyze Gashi Kallaba,Drejtorati për Planifikim ,Urbanizëm,Mbrojtje dhe Shpëtim,anëtare
7.Albert Mustafa,Drejtorati për Shëndetësi,anëtar
8.Teuta Berisha,anëtare,Drejtorati për Arsim,anëtare
9.Pranvera Krasniqi,Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport,anëtare
10.Makfirete Shamolli,Qendra për Punë Sociale,anëtare
11.Laureta Ahmeti,Drejtorati për Buxhet dhe Financa,anëtare

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numëri të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesi Bytyqi ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ne po e prezantojme draft-Planin Komunal Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit 2024-2026, ku i gjithë procesi i hartimit e deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi i Komunës i Lipjanit kemi kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Kryesuesi Diamant Bytyqi, ka vazhduar prezantimin e këtij dokumenti duke thënë se Komuna e Lipjanit, ka vizionin "Lipjani i së nesërmës do jetë qendër e rëndësishme në regjion, me ekonomi të zhvilluar e moderne brenda Trekëndëshit të Zhvillimit; do të mbështesë fuqishëm industrinë, turizmin dhe bujqësinë; do të ketë mjedis dhe infrastrukturë urbane e rurale të nivelit të lartë dhe të balancuar në vijën fshat – qytet, bazuar në zhvillimin e planifikuar; Lipjani do jetë Komunë e hapur për iniciativa private e ndërmarrësi, si dhe Komunë e zonave atraktive dhe të veçanta turistike. Lipjani me ide dhe profesioniste e profesionistë të reja / rinj, me nivel të lartë kulturor-arsimor dhe përmbajtje; Komunë e sportit dhe artit, Komunë e cila i kushton kujdes kategorive të ndjeshme të popullatës dhe përmirësimit të mjedisit jetësor – pra një Komunë atraktive për të jetuar dhe punuar.

Nënkryetari Bytyqi para të pranishmëve ka potencuar se bazuar në strategji dhe planin e veprimit për Barazi Gjinore në shoqërinë Kosovare 2024-2026.
Komuna e Lipjanit e bëri hartimin e këtij "Plani Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit 2024-2026".

Ky plan veprimi është hartuar bazuar kryesisht në sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, të cilët e kanë themeluar Grupin Punues Komunal për hartimin e këtij plani lokal të veprimit.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve që ka zhvilluar Grupi Punues Komunal për hartimin e planit lokal të veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 në Komunën e Lipjanit, ka vendosur që në kuadër të këtij plani të veprimit të përfshihen katër objektiva strategjike të PLVBGJ 2024-2026 të Komunës së Lipjanit objektiva kryesore, të cilat janë edhe pjesë e strategjisë shtetërore në nivel të Kosovës "Strategjia për Përfshirjen e Barazisë Gjinore 2024– 2026".

Grupi Punues Komunal ka vendosur që në kuadër të planit lokal të veprimit për përfshirjen e Barazisë Gjinore 2024-2026 në Komunën e Lipjanit të përfshihen katër objektiva si në vijim:

1. **Fuqizimi ekonomik, punësimi i denjë dhe promovimi i drejtësisë sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.**

2. **Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.**

3. **Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.**

4. **Promovimi dhe edukimi shëndetësor, promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.**

Diamant Bytyqi po ashtu ka njoftuar të pranishmit se në punëtorinë e parë për analizën e gjendjes për këto katër objektiva strategjike, është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Tutje nënkryetai i komunës z. Bytyqi, tha se Grupi Punues Komunal ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohet ky plan veprimi. Tutje, për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan veprimi është bërë analiza e gjendjes, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjikë, janë përcaktuar rezultatet e pritshme si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e situatës së përgjithshme për Barazinë Gjinore në Komunën e Lipjanit.

Po ashtu, janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të veprimit.






Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë qështje, lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Brazi Gjinore në Komunën e Lipjanit 2024-2026.

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar sqarime rreth këtij dokumenti.

| Temat e Konsultimit | Komentet | Kush ka komentuar | Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara | Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|---|---|---|
| Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 | Ka kërkuar që të përfshihen të gjitha Drejtoratet për Planifikim të Buxhetit për realizimin e këtij plani të veprimit ngase është edhe kërkesë nga ministrija e financave. | **Shkelzen Hajdini** | Diamant Bytyqi, kryesues i komisionit për hartimin e këtij plani ka thënë se Komisioni ka pranuar komentin edhe | Komenti u pranua plotësisht |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ka futur në këtë Plan | |
| Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 | Ka kërkuar që në këtë plan të përfshihet edhe informata mbi trashëgimin apo të drejtat që i takojnë grave edhe pse çdo ditë po rritet numri i pronave të regjistruara në në emër të grave. | **Magbule Sadiku-Murati** | Kryesuesi Diamant Bytyqi tha se në këtë plan janë të potencuara edhe informatat lidhur me të drejatat e grave mbi pronen. | Komenti u pranua plotësisht |
| Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 | Dukuria për martesat e hershme të komuniteteve propozon të parandalohen martesat e hershme. | **Lulzim Qerimi** | Komisioni për hartimin e këtij dokumenti ka thënë se do të përfshihet edhe pjesa ku flitet per parandalimin e martesave të hershme tek komunitetet që jetojnë në Komunën e Lipjanit. | Komenti u pranua plotësisht |
| Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 | U përshendet puna për hartimin e këtij plani i cili është në përputhje me planet tjera në të cilat ka kontrubuar edhe OSBE-ja. | **Kimete Jashanica - OSBE** | Komisioni për hartimin e këtij Plani ka falenderuar OSBE-në për kontributin | |

**Komentet që kanë arritur përmes postes elektronike**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Draft–Plani Lokal i Veprimit Barazi Gjinore i Komunës së Lipjanit 2024-2026 | Do të rekomandonte që të konsideroni përfshirjen e "personave nën mbrojtje ndërkombëtare" (me status refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese) dhe me status pa shtetësi, nën seksionet Hyrje dhe Vizioni, Objektivat Strategjike dhe Objektivat specifike, për të garantuar që të gjithë persona të cenuar nga kategoritë e mësipërme të specifikohen dhe përfshihen. | UNHCR | Komisioni për hartimin e këtij Plani ka thënë se Çështje që keni rekomanduar janë të rëndësisë së veçantë andaj do ti marrim në konsiderate dhe ti plotësojmë në draftin final. | Komenti u pranua plotësisht |

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **27** pjesëmarrës, prej tyre femra **22** dhe 5 meshkuj.

| Metodat e Konsultimit | Datat/kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve |
|---|---|---|
| 30 ditë pranohen | | 27 |
| 30 ditë | | |

**Bukurie Zejnullahu-Jashari**
**Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike**

**Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve**

**Bukurie Zejnullahu-Jashari**
**Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për draft - Planin Lokal të Veprimit të Barazisë Gjinore. 2024 - 2026.

**Datë:** 07.03.2024 ora 10:00

**Vendi:** Salla e Kuvendit

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Vendi | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Valdete Muji | SLLOVI | [signature] |
| 2 | PRANVERA KRASNIQI | SMALLUSHË | [signature] |
| 3 | Blerta Gashi | Akllap | [signature] |
| 4 | Kimete Jashamia | OSCE | [signature] |
| 5 | Laureta Ahmedi | Lipjan | [signature] |
| 6 | Butrint Bajrullahu | Lipjan | [signature] |
| 7 | Medina Bublica | Lipjan | [signature] |
| 8 | JALLDYZE KALLABA | DPUMM – LIPJAN | J. Kallaba |
| 9 | Kumrije Reçica | Prishtinë | [signature] |
| 10 | Albulena Salihu | Lipjan | [signature] |
| 11 | Saranda Krasniqi | Lipjan | [signature] |
| 12 | Samine Dragagjina | Lipjan | [signature] |
| 13 | Safete Amerllahu | Lipjan | [signature] |
| 14 | Shkelzen Hajdini | Lipjan | [signature] |
| 15 | Kulzim Qerimi | LIPJAN | [signature] |
| 16 | Elmaze Behluli | Poturoc | [signature] |
| 17 | Magbule Sadiku Musliu | Lipjan | [signature] |
| 18 | Afrdita Hetemi | LIPJAN | [signature] |
| 19 | Lidija Jovanović | Липљан | [signature] |
| 20 | Hyra Bytyqi | QYLAGË | [signature] |
| 21 | Xhyle Korqaj | SHALË | [signature] |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 22 | Linda Shahini | Magure - Lipjan | [signature] |
| 23 | Ferdion Shala | Lipjan | [signature] |
| 24 | Hisni [illegible] | [illegible] | [signature] |
| 25 | DIAMANT BYTYQI | | [signature] |
| 26 | ARTON BIRARU | UNNOUCA | [signature] |
| 27 | Qëndresa Jashanica | Lipjan | QJashanica |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |